

DISKURSI SATERIK NËVEPRËN “ I RINGJALLURI I PENDUAR “ AKD. REXHEP QOSJA

Arsim HALILI

Abstrakt

Rexhep Qosjes, është njëri nga personalitetet që i dha shumë fushës letrare artistike, studimore, historike, politike, esesistike, estetike, etj. Në shumësinë e veprave të Akd. Qosjes, të shumtën e rasteve del mospajtuës me ngjarjet që përjetoi populli ynë. Zëri i tij protestues, vazhdon në raport me rrethanat e disfavorshme të krijuara edhe pas luftës së fundit në Kosovë. Figura e Gjergj Kastriotit- Skënderbeut e transformuar në bronz, padyshim është burim i frymëzimit të atdhedashurisë. Artikulimi saterik narrativ, ku Qosja shfaq, ironinë, sarkazmën, madje mund të thuhet edhe pezimin e tij, gjithnjë duke aluduar në paknaqësitë, se ky vend duhet të ndryshoj qasjen e diskursit të filozofisë politike dhe jo vetëm, në atë masë që ë mos pendohen as të vdekurit kontribues të atdheut të përbashkët, natyrisht as të gjallët. Shikuar nga këndi i storiëve në rrëfimin e tregimit prototip janë figura politike të kohës, që manipulojnë me realitetin e thirrur në vazhdimsi si epokë tranzicionale, e që gjërat më shumë përkeqësohen se sa vihen në binar. Në fokus të punimit do të jetë se si Qosja e ndërton satirën e tij mbi komplekset narrative, përfaqësimi i shkallëve narrative dhe zhvendosja e tyre, sa ruhet elementi i ngjarjes, sa përfaqësohet zëri narrativ i fokaliatorit dhe vokaliatorit. Sigurisht njëqështje tjetër që do të ngrihet në diskutim të këtij punimi është a kemi prani të groteskut brenda kësaj proze. Mbi të gjitha do të kërkohet gjejtja e vendosjes së diskursit stilistik dhe retorik në zbukurimin të tekstit një element mjaft i pranishëm dhe i domosdoshëm në satire është edhe ekzagjerimi potencial, që te lexuesi të paraqitet komikja, përveç të qeshurës vjen edhe si reagim kritik subjektiv.

Fjalë kyçe : Ringjallje, pendim, satirë, grotesk, zë protestues, komikja, prototip, ekzagjerim.

Hyrje

Akd. Rexhep Qosja një figurë e rendësishme për letërsinë shqipe dhe jo vetëm i ka dhënë shumë, përveç pjesës artistike të letërsisë, natyrisht edhe fushës studimore e publicistike. Duke qenë njëri nga figurat qoftë i kyçur drejtpërdrejt në rrjedhat socio-politike, por edhe nga distanca, sidomos periudhën e pasluftës së fundit në Kosovë (1998-1999), natyrisht se ka ngritur shqetësimet e tij lidhur me fatin e popullit shqiptarë. Diskursi i tij qoftë publik-mediatik, por edhe krijues ka shenjëstruar gjithë ato rrjedha që po krijoheshin me pa të drejtë në kurriz të popullit tonë. Zëri i Akad. Qosjes për këto padrejtësi në disa qarqe u keqkuptua, madje edhe u keqinterpretu. Si do që të jetë Kosova e pasluftës duke u ndërtuar një sistem i ri politik, ekonomik, kulturor e social herë me ndihëm e faktorit të jashtëm e herë me forca tona, duket se me raste nuk shkonin në vijën e aspiratave të gjithë atyre që kontribuan e madje edhe sakrifikuan për këtë vend. Rrjedhimisht edhe Akd. Qosja, nuk ka mundur të qëndroj indiferent, nga prizmi i një figure intelektuale. Gjithë ajo që nuk ecën në proporcionin e duhur, përkundrazi nga klasa e jonë politike, instaloj këtë diskurs politik i cili nuk arsyetohej me aspiratat e masës së gjërë. Si rezultat i kësaj Qosja në pamundësi për të ndryshuar këtë diskurs që dukej se ecte mbrapsht, iu kundërvu me mjete të tjera intelektuale, përmes inkudrimin të satires, ironies në prozën e tij artistike. E që për rrjedhojë kishte një objektiv ata që kuptojnë mos të solidarizohen me të keqen që i vinte nga klasa politike duke u thirrur në emër të demokracisë e në fakt në zbatim nuk ishte asgjë më tepër se një sistem antivlerash utopiste. Për krijimtarinë letrare të Akd. Rexhep Qosjes, shkruan edhe studiuesi Agimi Vinca e cilëson si vijon:

*Vepra e tij është e gjerë dhe shumëllojshme: opusi krijues gati imponant si sasi dhe i një niveli të lartë cilësi, ndër më të mëdhenjtë dhe më cilësorët në letërsinë e sotme shqipe: i një rendësie të veçantë për letërsinë dhe kulturën shqiptare.*¹

Leximi i realitetit kosovar përmes satires

Satira ka qenë pranë nesh për një kohë shumë të gjatë. Në një nga format më të vjetra të regjistruara, te papiruset e pikturuara në Egjiptin e lashtë, rendi natyror i gjërave është kthyer së prapthi në mënyrë mjaftë zbavitëse. Një papirus 3000 vjeçar në Muzeun Britanik na u shfaq një luan duke luajtur një lojë tavoline me një gazelë (më vonë në sekuencë, të dy kafshët bëjnë seks) dhe një mace që kullot. Kjo satirë në aspektin më të thjeshtë e godet, në mënyrë indirekte, status quon, por nëse e shikojmë si vizatim, duket se është paraardhëse e drejtpërdrejtë e satirës vizatimore të ditëve tona, siç është “Dunsberi” nga Garry Trudeau ose skenat e serialit të animuar televiziv, “Simpsonët”.²

Duhet thënë që në krye të herës edhe në letërsinë shqipe një i tillë diskurs letrar ka qenë dhe vazhdon të jetë mjaft i përhapur, këtu kemi parasysh shkrimtarë me begandë të cilët i kanë dhënë letërsisë shqipe vepra të cilat si të tilla sa herë dhe në çdo kohë që lexohen ruajnë aktualitetin e tyre, pavarësisht kohën kur janë shkruar. Le të kujtojmë disa nga emrat e letërsisë sonë shqipe që krijuan një qasje për ato dukuri shqetësuese të realitetit të kohës siç janë: Çajupi e veprën e tij „Katërmbdhjetë vjeç dhëndërr“, Gjergj Fishta me veprën „Gomari Babatasit“, Faik Konica me veprën „Dr. Gjilëpra“. Le të përqendrohemi te njëri nga shkrimtarët protagonist të këtij seminari Akad. Rexhep Qosja. Duhet thënë se nuk është e vetmja vepër „Panteoni i rralluar“ me elemente saterike –filozofike, ndonëse në punimin tim do të përqendrohem te një vepër tjetër, kryekëput saterike „I ringjalluri i penduar“.

Ballafaqimi i fiksonit me realitetin në tregimin e satirës

*Nuk ka nevojë të shkruhen “romane humoristike”, kur ballafaqimet në jetën aktuale, nëse shkruhen kujdesshëm, janë komedi të mjaftushme*³

John Updike

Tregimi “I ringjalluri i penduar” i Rexhep Qosjes ka statusin e satirës, sepse kërkon leximin e tekstit karshi kontekstit të cilin e përqesh. Edhe pse e bënë pjesë të lojës edhe heroin kombëtar, tregimi nuk fiton statusin e parodisë, sepse nuk fishkullohet Skënderbeu, por ata që manipulojnë me figurën e tij. Parodia përmbys heronj, profetë, legjenda, kurse satira është zhanër që fitohet duke alternuar diskursin përqeshës me një temë aktuale politike. Në këtë tregim satira rri në prag të parodisë, sepse edhe habia e heroit shpesh shkakton të qeshura te lexuesi.⁴

Sipas studiuesit Ag Aplloni, këtë tregim e përcakton në tri parime të stilit retorik: Në atë të Euresis, Taxis dhe Lexis, le të përqendrohemi te secili parimi veç e veç.

Euresis

Tema e këtij tregimi është marrë nga realiteti politik kosovar. Krejt aventura e Skënderbeut realizohet gjatë një dite, me 28 nëntor 2001 dhe përfshin udhëtimin nga kufiri Shqipëri-Kosovë deri në Prishtinë. Pra, përveç kapitullit të parë, që rrëfen për lutjen dhe kapitullit të pestë që është një intermezoo. Gjashtë kapitujt tjerë rrëfejnë për udhëtimin dhe arritjen. Kështu, tregimi nis me një ekzagjerim tematik: kërkesë për prurjen e monumentit të

¹Agim Vinca, (Po) etika e Fjalës, ARS ZZ, Tetovë, 2010, fq 245.

² [Htp://www.telegafi.com](http://www.telegafi.com) Roli i satires në letërsi, publikuar 2021.

³ David Lodge, Arti i fiksonit, Amagedoni, Prishtinë, 2022, fq 148.

⁴ Rexhep Qosja, I ringjalluri i penduar, OM, Prishtinë, 2016, fq 5

Skënderbeut në Prishtinë kthehet në dëshirë dhe lutje për ringjallje të heroit kombëtar. Përtej petkut artistik, ne shohim në tregim që luan me figura të njohur të një partie kosovare, në fakt me marrëzitë e tyre që shpesh i kemi parë në realitet e në television dhe i kemi lexuar në gazeta.

Taxis

Bota narrative e tregimit “I ringjalluri i penduar”, përbëhet nga ngjarje reale politike dhe nga personazhe të njohura që mbanin poste të rëndësishme politike. Personazhet kanë prototipe politike, kurse narrator është e vetmja qenie fikzionale pa prototip në realitetin e lexuesit. Krejt rrëfimi kontrollohet nga narrator homodiegetik, mjeku dhe gazetari Çerem Çapari, i cili rrëfen për ato që sheh, lexon dhe dëgjon.⁵

Lexis

Pas gjetjes së temës së jashtëzakonshme, pas strukturimit zinxhiror, vjen faza e zbukurimit, e cila për nga radhitja është e treta, por për nga rëndësia estetike është e para. Kjo nënkupton procesin e zbukurimit të tekstit, “ornare verbi”. Kështu stili bëhet dekor dhe domethënie në të njëjtën kohë. Për ta zbukuruar diskursin saterik Qosja përdor të gjitha mjetet e nevojshme stilistike duke e mbushur me ekzagjerime, që janë teknika të zakonshme saterike, duke mos synuar të bëjë qeshjen komponente thelbësore të satirës, por duke e bërë ironinë militante, i vetdijshëm se dallimi kryesor mes ironisë dhe satirës është se satira është ironi militante.⁶

• Interpretime narrative të tregimit “I ringjalluri i penduar”

*Shndërrimi i vetës domethënë ndryshimi i mardhënive midis rrëfimtari dhe ngjarjes së tij pra edhe konkretisht ndryshimin e rrëfimtari është e qartë se kërkon një ndërhyrje më të madhe dhe më të qëndrueshme dhe më shumë mundësi i sjell me vete edhe pasoja më të mëdha.*⁷

Duhet theksuar se gjatë leximit të këtij tregimi me kujdes shohim se autori e vë narratorin në pozitën e tipit të katër sipas teorisë Genette, respektivisht ndërdisjetik- homodiegetik, ku rrëfimtari i shkallës së dytë rrëfen historinë e vet. Shembull për këtë kemi:

*Pas veturës me gazetarët vjen vetura me mjekët, ndihmësit e tyre dhe motrat mjekësore e në mesin e këtyre mjekëve kam pasur fatin, ja, të jem edhe unë, Çerm Çepuri. Sa herë më jepet rasti më i vogël, unë kujdesem ta bëj rast të madh dhe i afrohem Skënderbeut: dua ta shoh nga afër dhe ta dëgjoj çka thotë.*⁸

• Komente jo narrative

Komentet jo narrative brenda një teksti të një veprë letrare nuk janë aq të lehta të përcaktohen. Ndoshta shkrimtari i duhet të përzgjedh mes asaj që ka në mendje dhe asaj që mbarështron në përmbajtje dhe ide.

Studiuesja e Narratologjisë Mike Bal thotë qartazi:

*“Jo në ëdo fjali në një tekst mund të quhet “narrative”, sipas përkufizimeve të dhëna në këtë libër. Ndonjëherë ia vlen të analizohet alternimi midis përshkrimit dhe komentve jo narrative. Shpesh deklara të tilla bëhen deklarata ideologjike.”*⁹

Ndërsa studiuesi shqiptar Zejnullah Rrahmani thekson lidhur me komentet jonarrative:

*“Në përgjithësi teksti jonarrativ është një tekst komentues që shpreh një pikëpamje, është ideologjik dhe nuk lidhet me zhvillimin e ngjarjes në situatën e tekstit narrativ, po jep një imazh të idesë që zhvillohet atje.”*¹⁰

Lidhur me këtë çështje po i referohemi veprës së Qosjes ku hasen komente jonarrative.

⁵Rexhep Qosja, I ringjalluri i penduar, OM, Prishtinë, 2016, fq 6-7.

⁶Po aty, fq 9.

⁷Gerard Genette, Diskursi i rrëfimit, Dy lindje, dy perendime, Elbasan, 2014, fq 77.

⁸Rexhep Qosja, I ringjalluri i penduar, OM, Prishtinë, 2016, fq 38.

⁹Mieke Bal, Narratologjia, Artini, Prishtinë, 2021, fq 62.

¹⁰Zejnullah Rrahmani, Leximi dhe shkrimi, Faik Konica, Prishtinë, 2003.

Sa të huaj janë vrrarë në luftërat për çlirimin tuaj ? pyeti Skënderbeu?

- Për fat asnjë- u përgjigj I pyeturi .
- E sa shqiptarë janë vrrarë?
- Të veshur ushtarakisht një mijë a dy mijë a nuk e di sa! E din shokët e tyre. Po,të veshur të përditëshëm janë vrrarë rreth trembëdhjetëmijë, Lartëmadhëri.
- Ata që janë vrrarë të veshur ushtarakisht a janë edhe ata vëllzërit tuaj ?
- Vëllau si shkja, Lartëmadhëri thotë populli. ¹¹

Kompozicioni postmodern

Citatësia, intertekstualiteti dhe diskursi brikolar dy fenomene mjaft të rendësishme në prozë(roman ,novelë) dhe në këtë rast edhe në tregim integrohen qëllimshëm dhe me mjaft finesë artistike,jo si një kërkesë formale , jo si një ambiguitet, të panevojshme . duhet thënë se autori këtë diskurs e vë në veprim me qëllim të zgjerimit të strukturës stilistiko-semantike . ose siç shprehet studiuesi Ag Apolloni:

Tregimi i Qosjes, duke qenë diskurs brikolar, merr citate dhe modele nga kategori të ndryshme tekstesh dhe strukturohet si tregim, si novelë, si roman, si ese, si tekst filozofik, si tekst politik, si tekst publicistik etj. Meqenëse të gjitha këto lloje diskursesh që përbjnë “një pjatë me fruta të ndryshme” i shërbejnë autorit me tregue jo me shfaqë një histori, atëherë autori zgjedh dominanten dhe e cilëson veprën tregim , ndërsa vetë tregimit ia vë epitelin saterik. ¹²

Le të ofrojmë për lexuesin disa nga pjesët e diskursit brikolar

Luje nuse shtatin –o!

Sena shtove merakun – o!

Se na mbushe arkën -o!

Ose

Pjesë nga rapsodia servile e kohës së komunizmit ku këndohej kënga :

Marshall Tita në kali të bardhë... ¹³

Si dhe kujtojmë fjalët e Skënderbeut drejtuar popullit shqiptarë:

”Lirinë nuk ua solla unë, ate e gjeta mes jush”! ¹⁴

Përfundim

Duhet theksuar , ndërkaq se vepra akademik Rexhep Qosjes, pavarësisht nga forma në të cilën është shkruar: kritikë, estetikë, histori e letërsisë, ditar , biografi,prozë a dramturgji, apo publicistikë, ka karakter kompakt dhe përfshin vorbullën e saj në korpus temash ,idesh ,mesazhesh ,që në instancën e fundit , sillen rreth vlerave sublime të jetës njerëzore: lirisë, të drejtës , dhe të vërtetës. ¹⁵

Gjatë gjithë leximit të këtij tregimi të Qosjes u pa qartë se narratori,identifikohet me autorin veprës, ndonëse duhet kuptuar një gjë as narratori e as vet autori nuk janë aspak dakord me situatat krijuara dhe të identifikuar politike, por të të interpretuara me gjuhën saterike, del sa divergjencia krijohen. Megjithatë lexuesi i vëmendshëm të krijon situata retorike në formë pyetjesh . Pse e zgjedh autori-narrator ta rrëfej ngjarjen nga ky kënd saterik. A pranohen domosdoshmërisht faljet e mëkateve ne një tempull fetar dhe te një predikues, pikërisht po nga ata personazhe krijojnë një shumësi mëkatësh, duke u fshehur pas mbrojtjes së një vlere kombëtare siç ishte heroi Gjergj Kastrioti Skënderbeu. Sigurisht jo pa shkas Qosja e merr këtë pikë referimi figuren e heroit kombëtar Skënderbeun , thjesht dhe qartë

¹¹ Rexhep Qosja, I ringjalluri i penduar, OM, Prishtinë, 2016, fq 34.

¹² Po aty fq 10.

¹³ Po aty fq 82-83.

¹⁴ Po aty fq 100.

¹⁵.Agim Vinca , (Po) etika e Fjalës, ARS ZZ, Tetovë, 2010,fq 251.

për të gjykuar moralisht dhe politkisht përmes satires, gjithë ata politikan në kete rast që bëjnë dëme në kurriz të popullit . Kjo gjë do të ishte më pakta, sepse janë veprime diametraalisht të kundërta mes asaj që ndodh në politikën ditore dhe gjithë atyre që kanë sakrifikuar dhe bartin me pietë emrin e heroit .

Referencat

- [1]. Qosja Rexhep, I ringjaluri i penduar ,OM,Prishtinë, 2016.
- [2]. Vinca Agim, (Po) etika e fjalës, ARS ZZ, Tetovë, 2010.
- [3]. Rrahmani Zejnullah, Leximi dhe shkrimi , Faik Konica, Prishtinë, 2003.
- [4]. Genette Gerard, Diskursi i rrëfimit, Dy lindje dy perendime, Elbasan , 2014.
- [5]. Lodge David, Arti i fiksionit , Amagedoni,Prishtinë, 2022.
- [6]. Htp://www.telegrafi.com Roli i satires në letërsi.